

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE ILIRJANA I TABAKU



Nr. 2498 Rep.

Nr. 819 Kol.

Tirane, 26.05.2017

Adresa: Tirane, Rr. Durresit, Blloku Gintash, Godina 10/a

KONTRATË SHITJE

Sot, më datë 26.05.2017 (dymijë e shtatëmbëdhjete), para meje noteres publike Ilirjana Tabaku, Notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rr. Durresit, Blloku Gintash, Godina 10/a, u paraqitën palët e mëposhtme:

- **z. Ioannis TSOUKATOS**, shtetas grek, i biri i Georgios, lindur me 26.05.1949 ne Korydallos, banues ne Greqi, ne adresen Leonidion Kinourias (Peloponez), identifikuar prej pasaportes no. AK 2330614, **ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "DIMAX ALBANIA" SH.P.K**, regjistruar si person juridik me date 08.07.2013, pajisur me NIPT L31908006Q, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.11, Rr. Gjergj Legisi, Ish NUB Laprake, *ne vijim referuar si shitesi*
- **z. Lulzim KAPLLANAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Isufit, lindur me 15.11.1984 ne Fratar/Fier, banues ne Durres, Lagja 14, Rr. Vath Truja, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, person i njohur prej noteres, nr. personal I41115138A, *ne vijim referuar si bleresi*

Pale të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate me termat si më poshtë vijon:

Duke qenë se ekzistojnë keto kushte paraprake:

1. Shoqeria "DIMAX ALBANIA" sh.p.k, eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar si person juridik me date 08.07.2013, me zyre qendrore ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.11, Rr. Gjergj Legisi, Ish NUB Laprake, pajisur me NIPT L31908006Q, me kapital prej 100.000 (njqind mije)leke, me nje ortak.
2. Ortaku i vetem, z. Ioannis Tsoukatos, i cili zoteron masen prej 100 % të kapitalit të shoqërisë, me vlere 100.000 (njqind mije)leke, ka vendosur të shese masen prej 100% te kuotave te kapitalit qe i eshte ofruar per shitje z. Lulzim Kapllanaj, i cili e ka pranuar blerjen.
3. Shitja eshte miratuar nga mbledhja e Ortakut te vetem te Shoqerise, i cili ka dhene pelqimin sipas vendimit nr 7, date 25.05.2017.

Palet bien dakord për hartimin e kësaj kontrate shitje si më poshtë:

NENI 1.- OBJEKTI

Shitesi i shet bleresit masen prej 100 % te kuotave që zotëron në kapitalin e shoqërisë në gjendjen e faktit dhe të drejtave në të cilën ndodhet, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi kuotat.

NENI 2- CMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES

Cmimi i shitjes i vendosur me marreveshje te paleve eshte ne total 100.000 (njqindmije) LEKE dhe palet deklarojne se do te likujdohet nepermjet llogarise bankare ne emer te Ioannis Tsoukatos, prane BKT dhe do te vertetohet me mandatin bankar.

NENI 3- GARANCITË

Shitesi deklaron dhe garanton se është pronar i vërtetë i masës prej 100 % të kuotave të kapitalit të Shoqërisë. Shitesi deklaron gjithashtu se kuotat e kapitalit janë nënshkruar dhe shlyer prej tij në tërësinë dhe se janë të lire nga cdo barrë apo pretendim i të tretëve.

Bleresi ka pranuar blerjen e masës prej 100 % të kuotave që zotërohen nga shitesi, sipas vlerës së përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.

Bleresi garanton se me blerjen e masës prej 100 % të kuotave që zotërohen prej shitesit, merr persiper të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi kuotat.

NENI 4- KALIMI I PRONËSISË

Me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, shitesi do të humbasë të drejtat e tij mbi pronësinë e masës prej 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi to.

Nga ana tjetër, me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, bleresi do të bëhet pronar i masës prej 100 % të kuotave të shoqërisë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi to.

Kapitali i Shoqërisë **"DIMAX ALBANIA" sh.p.k.**, pas realizimit dhe regjistrimit të kësaj kontrate shitje do të zotërohet si më poshtë vijon:

- Lulzim Kapllanaj - 100 % te kapitalit.

NENI 5- SHPENZIMET E KONTRATËS

Shpenzimet noteriale dhe të hartimit të kësaj kontrate janë në ngarkim të Bleresit.

NENI 6- LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Cdo aspekt që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë do të disiplinohet nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që i referohen kontratave të shitjes dhe legjislacionit tregtar në fuqi.

NENI 7- ZGJIDHJA E MOSMARRËVSHJEVE

Në rast mosmarrëveshjeje rreth zbatimit dhe interpretimit të kësaj kontrate, palët bien dakord ta zgjidhin atë në rrugë miqësore. Në rast se kjo nuk është e mundur, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata.

NENI 8- DISPOZITA TË FUNDIT

Sa me sipër iu perkthye shtetasit grek, Ioannis Tsoukatos, nga perkthyesi zyrtar, znj. Anila Rezhda, lindur me 24.10.1966 ne Rubik, mbajtese e leternjofimit ID 024829339, nr. Personal G66024023V, pajisur me NIPT L02409010K, e cila me deklaroi se pasi i perktheu gjithcka nga shqip ne greqisht , e kuptoi dhe e pranoi.

Kjo kontratë u hartua ne katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe, me tre flete, dhe, pasi iu lexua palëve qarte e me ze te larte nga une noteri dhe u gjet në përputhje me vullnetin e tyre te plotë dhe të lirë ,u nënshkrua prej palëve pa asnjë vërejtje përpara meje Noterit .
Une Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

PALËT

SHITESI


TSOUKATOS IOANNIS


BLERESI






Perktheu

Anila Rezhda


NOTERE ILIRJANA I TABAKU



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20170526103322271
Data e Rezultatit të Kerkimit: 26.05.2017
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 10:33:22AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-157-1924
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

DIMAX ALBANIA SH.P.K.



Dei Karaj